



www.qbz.gov.al

63

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 63

Tiranë – E mërkurë, 21 prill 2021

PËRMBAJTJA

Faqe

Udhëzim i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 199, datë 12.4.2021	Për një ndryshim në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 64, datë 4.2.2021, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për dokumentacionin e nevojshëm, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës për heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, për personat që banojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.....	6245
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 219, datë 19.4.2021	Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia.....	6245
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 166, datë 20.4.2021	Për disa ndryshime në urdhrin nr. 162, datë 12.4.2021, “Për ndalimin e peshkimit në liqenet e Ohrit, Prespës, Fierzës, Ulzës dhe Shkopetit”.....	6246
	Aneksi 1 dhe aneksi 2, që duhej t’i ishin bashkëlidhur vendimit nr. 1189, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e kalimit të pronësisë, afatet, mënyrën e llogaritjes dhe të njoftimit të pagesës së truallit, zbritjet që përfitohen, si dhe miratimin e modelit të aktit të kalimit të pronësisë, në zonat e stimuluar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 57, datë 12.4.2021.....	6247

**UDHËZIM**

Nr. 199, datë 12.4.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E
PËRBASHKËT TË MINISTRIT TË
BRENDSHËM DHE TË MINISTRIT PËR
EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
NR. 64, DATË 4.2.2021,
“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
TË DETAJUARA PËR
DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM,
FORMËN DHE MËNYRËN E
PLOTËSIMIT TË KËRKESËS PËR
HEQJEN DORË DHE RIFITIMIN E
SHTETËSISË SHQIPTARE, PËR
PERSONAT QË BANOJNË JASHTË
TERRITORIT TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin e të përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, nr. 64, datë 4.2.2021, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për dokumentacionin e nevojshëm, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës për heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, për personat që banojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 2, të kreut V, “Rregulla dhe procedura të përgjithshme”, fjalë e parë ndryshon si vijon:

“Dokumentet e lëshuara nga shteti shqiptar duhet të mos kapërcejnë tre muajt e fundit nga data e lëshimit të tyre.”.

2. Ngarkohen strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Brendshme, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi**

**MINISTËR PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
Olta Xhaçka**

URDHËR

Nr. 219, datë 19.4.2021

**PËR KARANTINIMIN E PERSONAVE
QË VIJNË NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË NGA REPUBLIKA E
MAQEDONISË SË VERIUT
DHE GREQIA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, si dhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 1892 datë 19.4.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Vetëkarantinimin e detyrueshëm, për një periudhë 14-ditore, për të gjithë shtetasit që hyjnë në Republikën e Shqipërisë përmes rrugëve ajrore, tokësore ose detare nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia, nga data 20.4.2021 deri në datën 3.5.2021.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri organet kompetente për dhënien e masave administrative sipas aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga COVID-19”, i ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

**URDHËR****Nr. 166, datë 20.4.2021****PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN
NR. 162, DATË 12.4.2021, “PËR
NDALIMIN E PESHKIMIT NË
LIQENET E OHRIT, PRESPËS,
FIERZËS, ULZËS DHE SHKOPETIT”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 162, datë 12.4.2021, “Për ndalimin e peshkimit në liqenet e Ohrit, Prespës, Fierzës, Ulzës dhe Shkopetit”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Nënparagrafi i dytë i pikës 1, ndryshohet si më poshtë:

“Për krapin, prej 20 prillit deri më 20 korrik 2021, në liqenin e Ohrit, dhe prej 25 prillit deri më 25 maj 2021, për liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës dhe Shkopetit.”.

2. Pika 2, ndryshohet si më poshtë:

“2. Për periudhën 20.7.2021 deri më 20.8.2021, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore, prej 300 ml nga bregu, për liqenin e Ohrit dhe për periudhën 25.4.2021 deri më 25.6.2021, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën bregliqenore, prej 150 ml nga bregu, për liqenet e Prespës, Fierzës, Ulzës dhe Shkopetit.”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi



Aneksi 1 dhe aneksi 2, që duhej t'i ishin bashkëlidhur vendimit nr. 1189, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e kalimit të pronësisë, afatet, mënyrën e llogaritjes dhe të njoftimit të pagesës së truallit, zbritjet që përfitohen, si dhe miratimin e modelit të aktit të kalimit të pronësisë, në zonat e stimuluar", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 57, datë 12.4.2021.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KERKESE
PËR KALIMIN E PRONËSISË
MBI TRUALLIN FUNKSIONAL/TË LIRË NË ZONËN E STIMULUAR

Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: E-mail: Web: Shënim: Lutemi plotësoni me kujdes dhe qarte informacionin e kërkuar në fushat më poshtë:	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN Drejtoria/Zyra Vendore e ASHK _____
--	---

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN/ËT

☐ Person i stimuluar ☐ Subjekt i interesuar

1. Emër, Atësi Mbiemër: _____
Nr. identifikimi (ID): _____, Nr. cel: _____, Adresa: _____

OSE

Përfaqësuesi i autorizuar me prokurën nr. _____, datë _____:

1. Emër, Atësi, Mbiemër: _____
Nr. identifikimi (ID) : _____, Nr. cel: _____, Adresa: _____

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

Në mbështetje të nenit 49, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të Vendimit nr. _____, datë _____ të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e kalimit të pronësisë, afatet, mënyrën e llogaritjes dhe të njoftimit të pagesës së truallit dhe miratimin e modelit të aktit të kalimit të pronësisë, në zonat e stimuluar", kërkoj:

1. ☐ Kalimin në pronësi të truallit funksional/truallit të lirë me adresë: _____

SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

Personi i stimuluar:

- a. Vendimi për dhënien e titullit "person i stimuluar" ☐
b. Marrëveshje qeraje/zhvillimi ☐
c. Dokumentacion për miratimin e sheshit/lejes së ndërtimit ☐
ç. Të tjera ☐

Subjekti i interesuar

- a. Dokumentacion që provon porosinë, sipërmarrjen, premtim shitje, kalimin e pronësisë, mbi njësinë ☐

SEKSIONI D: PAGESA

Tarifë shërbimi për miratimin e dokumentacionit të pronësisë: 10 000 (dhjetëmijë) Leke.

Institucioni përfitues: Emërtimi _____ Kodi _____ Nr. llogarisë _____ IBAN _____



2254055716291

Kërkesës i bashkëlidhet kopje e dokumentit të identifikimit, si dhe dokumentacioni shtesë (jo i detyrueshëm):



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA _____

VENDIM

Nr. _____, datë _____

PER

KALIMIN E PRONËSISË MBI TRUALLIN FUNKSIONAL/TE LIRE
BRENDA ZONËS SE STIMULUAR/ DHE LEGALIZIMIN E NDERTIMIT PA LEJE

Në bazë të nenit 49 të ligjit 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të Vendimit nr. _____, datë _____ të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e kalimit të pronësisë, afatet, mënyrën e llogaritjes dhe të njoftimit të pagesës së truallit dhe miratimin e modelit të aktit të kalimit të pronësisë, në zonat e stimuluar", u mor në shqyrtim kërkesa (nr. _____ datë _____) e personit të stimuluar/subjektit të interesuar _____ për kalimin në pronësi të truallit të njësishë ndërtimore/truallin e lirë brenda zonës së stimuluar _____:

Parashtrimi i fakteve: (Këtu të listohen: Të dhënat e kërkesës; Të dhënat e dokumentacionit të dorëzuar nga personi i stimuluar/subjekti i interesuar me kërkesën për kalim pronësie; Shpjegimet e situatës faktike dhe veprimeve administrative të kryera nga ASHK; Të dhënat e gjendjes ndërtimore dhe gjendjes juridike të pasurisë sipas planit të rilevimit; Gjendjen faktike dhe ligjore të njësishë së ndërtuar (është ndërtim me leje të organeve kompetente ose jo); Sipërfaqja e truallit funksional/të lirë për të cilën miratohet kalimi i pronësisë; Mënyra e llogaritjes, cmimi i shitjes, vlera financiare dhe të dhënat e dokumentit që provon shlyerjen e detyrimit për kalimin e pronësisë; Shpjegime mbi vlerësimin e provave).

Vlerësimi dhe arsyetimi ligjor: (Shpjegimet mbi plotësimin e kritereve dhe shkaqet ligjore të miratimit të kërkesës)

Në përfundim, Drejtoria Vendore e ASHK-së _____ pasi kreu verifikimet e nevojshme, në mbështetje të dokumentacionit të hartuar dhe atij të administruar nga personi i stimuluar/subjekti i interesuar, bazuar në nenin 49, të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë dhe pikës _____ të Vendimit nr. _____, datë _____ të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e kalimit të pronësisë, afatet, mënyrën e llogaritjes dhe të njoftimit të pagesës së truallit dhe miratimin e modelit të aktit të kalimit të pronësisë, në zonat e stimuluar",

VENDOSI:

1. Kalimin e pronësisë, mbi pasurinë truall funksional me numër _____; në zonën e stimuluar _____, zona kadastrale nr. _____, me sipërfaqe sipas genplanit

KY DOKUMENT PLOTËSOHET NË TRE KOPIJE DHE SHQËRROHET NGA GENPLANI I PASURISË/PLANIMETRITË SIPAS RASTIT DHE DOKUMENTACIONI PËR SHLYERJEN E VLERËS SË TRUALLIT



- _____ m2 dhe vlerë _____ () Lekë, shlyer nga personi i stimuluar/subjekti i interesuar brenda _____ ditësh nga data e njoftimit.
2. Kalimin e pronësisë, mbi pasurinë truall i lirë me numër____; në zonën e stimuluar____, zona kadastrale nr.____, me sipërfaqe sipas genplanit _____ m2 dhe vlerë _____ () Lekë, shlyer nga personi i stimuluar/subjekti i interesuar brenda _____ ditësh nga data e njoftimit.
3. (Kjo dispozitë bëhet pjesë e vendimit në rastin kur miratohet edhe legalizimi i ndërtimit pa leje). Legalizimin e ndërtimit pa leje, përfshirë në procedurat e legalizimit nëpërmjet aplikimit Nr.____ prot., datë _____, me Numër Unik (INDEX), me këto të dhëna:
- a) Numër pasurie _____
 - b) Zona kadastrale _____
 - c) Sipërfaqe baze _____ m2
 - d) Sipërfaqe e përgjithshme e ndërtimit _____ m2
 - e) Numër katesh _____
 - f) Adresa _____
4. Ky vendim regjistrohet sipas procedurës së parashikuar në nenin 47 të ligjit 111/2018 "Për kadastrën" dhe pas plotësimit të kushteve të parashikuara në pikën _____ të Vendimit nr. _____, datë _____ të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e kalimit të pronësisë, afatet, mënyrën e llogaritjes dhe të njoftimit të pagesës së truallit dhe miratimin e modelit të aktit të kalimit të pronësisë, në zonat e stimuluar".
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim administrativ në përputhje me nenin 66 të ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e poceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe me Kodin e Procedurave Administrative".
6. Ky vendim i njoftohet subjekteve të interesuara brenda 10 ditëve nga miratimi i tij.

DREJTOR

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 32 lekë